

STATUTI

I

SHOQERISE "ETER GROUP" Shpk

KAPITULLI I

Forma ligjore, emertimi, selia e shoqerise.

Neni 1

Forma juridike

Ne mbeshtetje te vullnetit te Ortakeve te shoqerise, si dhe ne pajtim te plote me dispozitat e Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" neni 81 "per riorganizimin e shoqerive me pergjegjesi te kufizuar dhe ligjit 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", organizohet Shoqeria Tregtare "ETER GROUP" Shpk, e cila do te funksionoje sipas dispozitave te vendimit te asamblese dhe te ketij statuti.

Neni 2

Shoqeria ka per objekt veprimtarie te saj:

- Ndërtimin e centraleve Fotovoltaike (Diellore), Hidroteknike etj, te cilat bejne te mundur shfrytezimin e energjise qe gjendet ne natyre dhe qe jane te rinovueshme. Prodhim i energjise elektrike nga burimet e rinovueshme Fotovoltaike (Diellore). Shitja e energjise elektrike klienteve dhe blerja e energjise elektrike nga operatore te ndryshem privat apo shtetror brenda dhe jashte vendit. Transmetimi i energjise elektrike ne sistemin e tensionit te larte, funksion i cili perfshin transmetimin ose interkonjeksionin nderkombetar. Perdorimin e sistemeve te linjave, strukturave mbeshtetese dhe pajisjesh transformuese per transmetimin e energjise elektrike. Shperndarjen, transportin e energjise elektrike ne sistemet shperndarese te tensionit te mesem dhe te ulet, duke patur parasysh shperndarjen deri tek konsumatori i fundit. Shërbimet konsulente dhe komisionit financiar të ndërmjetësimit për blerjen, shitjen, prodhimin instalimin e sistemeve të ripërtëritshme të energjisë, formave diellore, turbinave të erës dhe sistemeve hidroelektrike të shfrytëzuara për vete ose për llogari të palëve të treta, marketingun dhe prodhimin e sistemeve elektronike (Software), komponentët e sistemet periferike për burimet e rinovueshme. Tregtim dhe mirëmbajtjen e të gjitha llojeve të makinerive elektromekanike, ajër të kondicionuar, makineri termohidraulike, tregtimin e materialeve të ndërtimit si dhe ndërtimin e marketingun e makinerive të teknologjisë së lartë, elektrike dhe pajisjet elektronike. Kryerja e studimeve për ngrohje, gaz, pajisje hidraulike dhe instalimet elektrike. Ndermjetsim financimi(kredi) me institutet financiare, bankat e nivelit te dyte, te huaja ose vendase per huadhenie per vete ose pale te treta. Sherbim konsulente ne fushen juridike, financiare dhe teknologjise se informacionit dhe komunikimit (TIK). Shoqëria brenda hapsirave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, do të kryeje cdo operacion tregtar dhe financiar që lidhet drejtëpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e veprimtarisë së saj. Kjo përfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive të tjera, krijimin e sipërmarrjeve të reja dhe pjesmarrjen në sipërmarrje të tjera, brenda dhe jashtë vendit. Shoqëria mund të kryej edhe aktivitete të tjera shtesë, me qëllim përmbushjen e veprimtarisë të saj kryesore në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

- Te sherbeje si perfaqesuese shitjeje e marketingu, agjent shitje per shoqeri vendase dhe te huaja, te angazhohet ne shitje me shumice dhe pakice dhe te hape dyqane per kete qellim, dege apo zyra po te jete e nevojshme brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise per arritjen e qellimit te shoqerise.
- Shoqeria mund te beje ose mund te kerkoje regjistrimin ne emer te saj, transferoje apo te tregtoje si te njejta, patenta e te drejta autori, marka te ndryshme, marketingu, licensa, tituj tregtie si dhe te drejta te ngjashme intelektuale dhe industriale.
- Ndertim, projektim, planvendosje e objekteve te veçanta, projektme dhe ndertime civile, industriale, hidroenergjitike.Ndertim digash dhe tunele hidroteknike. Ndertimi i Impianteve per prodhimin e Energjise Elektrike. Shitje, shperndarje, transmetim dhe prodhim energjie elektrike. Çdo aktivitet tjetër ekonomik, tregtar, financiar, qe gjykohet e nevojshme dhe e dobishme per realizimin e objektit te shoqerise, perfshire shitjen e mjeteve te shoqerise si makinerite, pajisjet, marrja dhe dhenia me qira, te qenit garant, hipotekimi dhe pjesemarrja ne shoqeri te tjera. Çdo operacion tregtar, operacione qe lidhen me pasurite e luajtshme dhe te paluajtshme, operacione financiare dhe kredimarrje, t'u jape garanci te treteve si dhe te bleje dhe shese ose marre me qira ndermarrje, dege ndermarrjesh, si dhe te kete pjesemarrje ne shoqeri te tjera, ente ose konsorciume, te themeluara apo ne themelim e siper, qe kane objekt te njejte ose te ngjashem, me te vetin apo gjithsesi funksional per arritjen e qellimeve te shoqerise.
- Dhenia e konsulences ekonomike,juridike,inxhinierike dhe profesionale; pergatitje dhe mirembajtja e dokumentacionit juridik, administrativ, teknik, projektme etj ne te gjitha fushat per te tretet, si dhe perfaqesimi i tyre ne te gjitha shkallet e gjykimit, nepermjet Zyres Juridike te Shoqerise.
- Import–eksport dhe shitje me shumice dhe pakice te mallrave e lendeve te para per industrine e ndertimit.
- Import–eksport dhe shitje–blerje me shumice dhe pakice te karburanteve e lubrifikanteve.
- Import–eksport dhe shitje–blerje me shumice dhe pakice te makinave dhe autoveturave te te gjitha llojeve e tonazheve.
- Import–eksport dhe shitje–blerje me shumice dhe pakice te mallrave ushqimore, lendeve te para, cigare, medikamente mjekesore, paisjeve elektrike, elektronike, hidrosanitare, hidraulike, duraluminit, pllakave te te gjithave llojeve, plastikes, gomes, bimeve mjekesore, lendes drusore e mobiljeve te linjave te prodhimit e perpunimit, konfeksioneve, por pa u kufizuar veten ne keto.
- Veprimtari ne fushen e ndertimit, prodhimi dhe tregtimi i materialeve te ndertimit, import eksporti i tyre brenda dhe jashte vendit per llogari te vete shoqerise dhe te treteve.
- Vendosja ne dispozicion te klienteles, ambjente te pershtatshme per te prezantuar mallrat tregtareve, mediatoreve dhe biznesmeneve te interesuar per shitblerjen e mallrave te ndryshem.
- Veprimtari ne fushen e turizmit, me qellim jo vetem ngritjen por edhe shfrytezimin dhe zhvillimin e veprimtarive ne fushen e hotelerise dhe te fshatrave turistike te pushimit, qendrave te argetimit, brenda dhe jashte vendit, si dhe te bleje, te marre dhe te jape me qera, te ndertoje apo te nxise ndertimin e tyre, duke vepruar ne kete fushe apo me partnere te tjere. Bar- restaurant, veprimtari ne fushen e argetimit, si salla pingpongu, bilardoje dhe lojra te tjera argetuese.

Neni 3

Emertimi

Emertimi i shoqerise do te jete “**ETER GROUP**” Shpk

Neni 4

Selia, Agjencite dhe Zyrat e Perfaqesimit

Selia e Shoqerise do te jete ne : **Rruga Thoma Koxhaj, Kompleksi Ales, Shkalla. 1, Ap. 32, Njesia Bashkiake nr. 6, Yzberish,Tirane.**

Shoqeria mund te krijoje dege, agjenci dhe zyra perfaqesimi te reja brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise. Ato krijohen dhe prishen me vendim te Asamblese se Ortakeve.

KAPITULLI II

KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT NDRYSHIMET E KAPITALIT

Neni 5

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte i perbere nga shuma prej 10 000 leke. Ai eshte i ndare, ne 2 kuota. Kuotat jane te numeruara nga 1 deri 2. Ortaket e shoqerise jane:

1. EDISON LLAHA, i datelindjes 10.12.1990 me leternjoftimi nr. J01210082B, lindur ne Prrrenjas, Shqiperi, i cili zoteron 1 kuote qe perben 50% te kapitalit ne kapitalin themeltar te shoqerise e barabarte me vleren 5000 leke.
2. ERIKLENTA SELIMAJ, e datelindjes 24.08.1985 me leternjoftimi nr. I55824069F, lindur ne Prrrenjas, Shqiperi, e cila zoteron 1 kuote qe perben 50 % te kapitalit ne kapitalin themeltar te shoqerise e barabarte me vleren 5000 leke

Neni 6

Forma e Kuotave

Kuotat e Shoqerise jane te zakonshme nominative.

Pronesia e Kuotave vertetohet nga regjistrimi i tyre ne emer te pronareve ne QKB.

Kuotat jane te pandashme. Me mareveshje te vecante midis ortakeve kuota mund te ndahet.

Neni 7

Shitja dhe transferimi i Kuotave

Perveç rastit te trashegimise, transferimi i pronesise mbi Kuotat e nje te treti, pavaresisht nga baza juridike e ketij transferimi, duhet te miratohet nga Asambleja e Ortakeve ne kushtet dhe sipas procedurave te parashikuara ne nenin 73 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

Sipas pikes 2 te nenit 73 vetem per pjestaret e familjes kalimi kuotave behet me vendim asamblese dhe me kontrate me shkrim.

Ne qofte se Asambleja ka refuzuar shitjen e kuotave nje blesesi qe nuk eshte ortak, shitesi duhet te njoftoje shoqerine me leter rekomande brenda 8 diteve nga data e njoftimit te realizimit, nese ka hequr dore nga projekti i shitjeve te Kuotave. Ne rast se shitesi nuk ka hequr dore nga ky projekt, asambleja duhet te siguroje blerjen e Kuotave prej nje ose disa persona te zgjedhur prej tij.

Ne qofte se, per vleresimin e Kuotave nevojitet nje akt ekspertimi, shpenzimet paguhen pergjysem te ndara midis shitesit dhe blesesit.

Neni 8

Zmadhimi i kapitalit themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise mund te zmadhohet sipas menyrove dhe rregullave te parashikuara ne nenet 168 ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

Zmadhimi i kapitalit themeltar mund te behet vetem me Vendim te Asamblese se ortakeve, ne baze te raportit te drejtorise, te hartuar ne menyren e kerkuar nga ligji me me shume se 75% te votave.

Kjo e drejte eshte ne perpjestim me shumen e kuotave te zoteruara nga ortaket perpara zmadhimit te kapitalit.

Ortaku mund te heq dore nga e drejta per nenshkrimin e kuotave te reja. Ai, gjithashtu, ka te drejte te kerkoje nenshkrimin e nje numri me te vogel kuotash nga sa i takon sipas parimit te perpjestueshmerise, por me kusht qe Asambleja te kete vendosur shprehimisht per kete gje.

Neni 9

Shlyerja e Kuotave

Kuotat per kapitalin ne para te nenshkruara ne zbatim te nje vendimi per zmadhimin e kapitalit do te shlyhen per 100% te vleres se tyre qe ne castin e nenshkrimit.

Pjesa tjeter e vleres do te shlyhet me keste, ne baze te kerkimit per shlyerje nga asambleja brenda nje afati 3 vjet nga data kur zmadhimi i kapitalit eshte kryer perfundimisht.

Asambleja e Pergjitheshme qe vendos zmadhimin e kapitalit, ka te drejte te marre vendimin per shlyerjen teresore te kuotave qe ne castin e nenshkrimit ose brenda nje afati me te shkurter, nga ai i permendur ne paragrafin e dyte te ketij neni.

Kerkimi i fondeve u njoftohet nenshkruesve te pakten 15 dite perpara dates se caktuar per cdo derdhje, me leter rekomande dhe me kthim pergjigje, drejtuar cdo pronari te kuotave.

Cdo vonese ne derdhjen e shumave te kerkuara sjell pagimin e interesave sipas perqindjeve te caktuara me ligj, duke filluar nga data e kerkimit te cdo derdhjeje pa qene nevoja per te proceduar ne formalitete te tjera te c'faredoshme dhe pa hequr dore nga veprimet e Shoqerise ndaj Ortakeve te detyruar dhe nga masat e zbatimit te detyruar te parashikuara nga ligji.

Neni 10

Zvogelimi i kapitalit themeltar

Zvogelimi i kapitalit themeltar te shoqerise kryhet vetem me Vendim te Asamblese te Pergjitheshme te Ortakeve dhe ne pajtim me dispozitat e neneve 81 te ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare". Zvogelimi i kapitalit themeltar nuk duhet te cenoje raportet e ortakeve para ketij zvogelimi.

Kapitali themeltar nuk mund te zvogelohet nen shumen minimale te kerkuar nga ligji.

Neni 11

Te drejtat dhe detyrimet e lidhura me kuotat

Cdo kuote jep te drejten e pjesemarrjes ne fitimet vjetore te shoqerise te destinuar per shpendarje dhe ne tepricen e aktivitetit te mbetur ne rastin e likuidimit, ne perpjestim me kuotat qe zoteron.

Pronesia mbi kuotat jep edhe te drejten e votes dhe te perfaqesimit ne mbledhjet e Asamblese se Pergjitheshme ne kushtet e percaktuara ne ligj dhe ne statut.

Ortaket pergjigjen per detyrimet e shoqerise ndaj te treteve dhe per humbjet e saj deri ne masen e shumes normale te kuotave qe zoteron. Ndalohet kerkimi i fondeve te kesaj shume.

Kur kuotat u kalojne ortakeve te rinj, keta ruajne te drejtat e detyrimeve qe vijne nga kuotat.

Pronesia e nje kuote permban automatikisht te drejten e aderimit ne statutin e shoqerise dhe ne vendimet e Asamblese se Pergjitheshme.

KREU 4

ORGANET DREJTUESE

NENI 12

Organet drejtuese te shoqerise do te jene:

- Asambleja e ortakeve
- Administratoret

Fusha e veprimit, perberja dhe menyra e funksionimit e organeve drejtuese rregullohet si me poshte.

ASAMBLEJA

NENI 13

Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e permendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë e ndarjen e fitimeve;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- j) për pikat (b),(ë),(gj) dhe (e) shoqëria duhet marrë vendime me 75% të votave,

2. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat “e” dhe “ë” të pikës 1 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.

3. Nëse shoqëria zotërohet nga një ortak, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 14

Mbledhja e asamblesë së përgjithshme

1. Asambleja e përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara nga ky ligj, nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë.

Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

2. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët e përcaktuar sipas nenit 83 të ligjit.

3. Asambleja e përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

4. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

5. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

6. Në rastet e parashikuara në pikat 3 e 5 të këtij neni, asamblesë së përgjithshme i paraqitet një raport nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur.
7. Dispozitat e pikës 6 të këtij neni nuk zbatohen nëse blerjet, sipas pikave 4 e 5 të këtij neni, kryhen në bursë ose janë pjesë e veprimeve të përditshme të shoqërisë dhe bëhen në kushte normale tregu. Gjithashtu, këto dispozita nuk zbatohen në rastin kur shoqëria zotërohet nga një ortak i vetëm.
8. Në rastet e parashikuara në pikat 3 deri në 5 të këtij neni, asambleja e përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorëve.

Neni 15

Mënyra e thirrjes

1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statute ose sipas nenit 83 të ligjit, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
2. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

ORGANI ADMINISTRATIV

ADMINISTRATORËT

Neni 16

Emërimi, shkarkimi, të drejtat dhe detyrimet

1. Asambleja e përgjithshme emëron si administratorë të shoqërisë si me poshte vijon:
Administrator i përgjithshëm emërohet zj. ERIKLENTA SELIMAJ
Afati i emërimit është 5 vjet nga dita e regjistrimit në QKB, me të drejtë ripërtëritjeje.
Sipas rrethanave që krijohen, shoqëria mund të emërojë edhe me shume se një administrator. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
2. Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
3. Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:
 - a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
 - c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim; të kryejnë beprime bankare si derdhje terheqje, pagesa etj sipas nevojave të shoqërisë.
 - d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit; (administrator i përgjithshëm)
 - e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë;
 - ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
4. Në rastet e parashikuara nga ligji, administratorët janë të detyruar të thërrasin asamblenë e përgjithshme.
5. Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.
Pas miratimit të këtij Statuti, përgatiten rregulloret e tjera, të miratuara nga asambleja e përgjithshme, të cilat mund të parashikojnë vecorite për detyrat e cdo administratori.
6. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Paditë, që lidhen me

shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 17

Përfaqësimi

1. Kufizimet e tagrave të përfaqësimit të administratorëve i kundrejtohen palëve të treta, në përputhje me dispozitat e nenit 12 të këtij ligji.
 2. Administratori i përgjithshëm përfaqëson shoqërinë tregtare në mardhenie me të tretet. Vetëm ai mund të autorizojë njerin prej administratorëve të tjerë për kryerjen e disa veprimeve të caktuara apo për kryerjen e disa kategorive të caktuara veprimesh.
- Njoftimet e drejtuara secilit prej administratorëve janë të vlefshme e detyruese për shoqërinë.
3. Tagrat e përfaqësimit të administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 18

Shpërblimi

1. Shpërblimit bazë të administratorëve mund t'i bëhen shtesa, që mund të jenë përqindje në fitim ose të ngjashme. Shpërblimet e administratorëve përcaktohen me vendim të zakonshëm të asamblesë së përgjithshme.
2. Shpërblimi, sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të jetë i përshtatshëm dhe në përputhje me detyrat e administratorëve dhe gjendjen financiare të shoqërisë.
3. Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, asambleja e përgjithshme mund të vendosë reduktimin e shpërblimit të administratorëve në masën e përshtatshme.
4. Kriteret e shpërblimit, shpërblimi individual dhe efekti vjetor i shpërblimit të administratorëve në strukturën e kostove të shoqërisë tregtare publikohen së bashku me pasqyrat financiare vjetore.

Neni 19

Detyrimi i besnikërisë dhe përgjegjësia

1. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas këtij ligji, administratorët detyrohen:
 - a) të kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
 - b) të ushtrojnë kompetencat që u njihen në ligj, në statut ose rregullore vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c) të vlerësojnë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - ç) të parandalojnë dhe mënjanojnë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
 - d) të garantojnë miratimin e marrëveshjeve sipas dispozitave të ligjit;
 - dh) të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratorët, gjatë kryerjes së detyrave të tyre, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
3. Nëse administratorët veprojnë në kundërshtim me detyrat dhe shkelin standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojnë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratorët kanë barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratorët janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, kryejnë veprimet e mëposhtme:
 - a) u kthejnë ortakëve kontributet;
 - b) u paguajnë ortakëve interesa apo dividendë;
 - c) u shpërndajnë aktivet e shoqërisë;

ç) lejojnë që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) japin kredi.

5. Dispozitat e mesiperme zbatohen edhe për paditë, që rrjedhin nga paragrafët e këtij neni. Këto padi duhet të ngrihen brenda 3 vjetëve nga kryerja e shkeljes apo nga zbulimi i saj.

KAPITULLI V

Kontrolloret e pavarur (Eksperti Kontabel i Autorizuar)

Neni 20

Emerimi dhe shperblimi

Asambleja e ortakeve të shoqërisë cakton 1 ekspert kontabel të pavarur nga listat e Institutit të Eksperteve Kontabel të Autorizuar.

Ne caktimin e kontrolloreve të pavarur mbahen parasysh përjashtimet dhe papajtushmerite të percaktuara nga ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Kontrolloret e pavarur caktohen për një kohë prej një viti, që i përgjigjet një viti financiar.

Eksperti është i riemerushëm deri 7 vjet radhazi.

Shpërbimi i kontrolloreve të pavarur caktohet nga Asambleja e Ortakeve dhe përballohet nga shoqëria.

Neni 21

Detyrat dhe të drejtat

Detyrat dhe të drejtat e kontrolloreve të pavarur të shoqërisë janë ato të parashikuara nga ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe ligji 10091 datë 05.03.2009 "për auditimin dhe mbajtjen e llogarive".

Asambleja e ortakeve të shoqërisë mund t'u kerkojë kontrolloreve të pavarur kryerjen e kontroleve apo verifikimeve të posaçme për çështje me interes të shoqërisë. Ekspertët kontabel të autorizuar thirren në mbledhjen e drejtorisë që mbyll llogaritë e vitit financiar si dhe në të gjitha Asambletë e Ortakeve. Me marrjen e raportit të eksperteve kontabel të autorizuar Asambleja miraton raportin dhe bilancin e shoqërisë. Raportet që ata përgatitin depozitohen në selinë e shoqërisë dhe në organet shtetërore të QKR, në afatet e parashikuara nga ligji.

KAPITULLI VI

LLOGARITE VJETORE, CAKTIMI I REZULTATIT

Neni 22

Viti financiar

Shoqëria përgatit çdo vit financiar llogaritë vjetore në pajtim me ligjin për kontabilitetin. Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor.

Neni 23

Caktimi i rezultateve

Rezultati i vitit financiar nxirret dhe caktohet në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe mbas dënies së raportit perfundimtar nga ekspertët kontabel të autorizuar.

KAPITULLI VII
PRISHJA, LIKUJDIMI, KUNDERSHTIMET

Neni 24

Prishja, likujdimi

Ne rastin e prishjes te shoqerise nje ose disa likuidatore emerohen nga Asambleja e ortakeve te shoqerise. Likuidatori perfaqeson shoqerine. Ai ka kompetenca te plota per te realizuar aktivitetin e shoqerise, te shlyeje kreditorët dhe te shperndaje mbetjen e disponueshme.

Ndarja e aktivitet neto qe mbetet pas rimbursimit te nominalit te kuotave behet midis ortakeve ne perpjestim me pjesmarrjen e tyre ne kapital.

Neni 25

Zgjidhja e mosmarrveshjeve

Te gjitha mosmarrveshjet gjate funksionimit te shoqerise ose gjate likuidimit te saj qe lindin midis shoqerise dhe ortakeve ose midis vete ortakeve, lidhur me veprimtarine e shoqerise, i nenshtrohen juridiksionit te gjykatave kompetente ne kushtet e parashikuara nga legjislacioni Shqiptar ne fuqi.

Neni 26

Ky statut perpilohet ne 2 kopje te barabarta. Perverc neneve te ketij statuti, jane te detyruesheme te zbatohen edhe kerkesat e tjera te ligjit 9901 date 14.04.2008 "per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe ligjet e tjera te shtetit shqiptar qe rregullojne bashkepronesine.

Date: 20.01.2023

ORTAKET THEMELUES

EDISON LLAHA

Edison Llaha


ERIKLENTA SELIMAJ

Eriklenta Selimaj
